

## GJYKATA E APELIT

**Numri i lëndës:** PAKR 978/12

**Data:** 25 korrik 2013

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtari i EULEX-it Tore Thomassen si kryetar i kolegjit dhe gjyqtar raportues dhe nga anëtarët e kolegjit – gjyqtarja e EULEX-it Annemarie Meister dhe gjyqtari Vahid Halili, në pjesëmarrjen e zyrtares ligjore të EULEX-it Anna Malmström, si procesmbajtëse

Në procedurën penale kundër të pandehurve:

**S.M.1.**, me nofkën \_\_\_\_\_, i lindur më XX.XX.19XX në fshatin \_\_\_\_\_ (\_\_\_\_\_), nga prindërit K.M. dhe S.M., shtetas i Kosovës, me shkollim të kryer fillor, i martuar, baba i dy fëmijëve, me profesion \_\_\_\_\_, me gjendje ekonomike mesatare, i padënuar më herët;

**S.M.2.**, me nofkën \_\_\_\_\_, i lindur më XX.XX.19XX në fshatin \_\_\_\_\_ (\_\_\_\_\_), nga prindërit K.M. dhe S.M., shtetas i Kosovës, me shkollim të kryer të mesëm, i martuar, baba i tre fëmijëve, me profesion \_\_\_\_\_, me gjendje ekonomike të dobët, i/e padënuar më herët;

Të liruar në shkallën e parë nga vepra penale *krime lufte kundër popullsisë civile* në kundërshtim me nenet 22 dhe 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KP të RSFJ-së), aktualisht të dënueshëm me nenet 23 dhe 120 (2) të Kodit Penal të Kosovës (KPK), në kundërshtim me nenin e përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të datës 12 gusht 1949 (“neni i përbashkët”) dhe me nenet 1 dhe 17 të Protokollit II të datës 8 qershor 1977, “Protokollit Shtesë II” të Konventave të Gjenevës, të gjitha rregullat e ligjit ndërkombëtar në fuqi në kohën e konfliktit të armatosur në Kosovë gjatë gjithë kohës e cila ka të bëjë me akuzën e tanishme ndaj të pandehurve si pjesëtarë të policisë së Serbisë ose pjesëtarë paramilitarë, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin dhe me pjesëtarët e tjerë serbë ushtarakë apo paramilitarë, duke përfshirë personat **S.F.**, **I.P.**, **D.T.**, **S.T.1.**, **S.T.2.** dhe **N.P.**, kanë trajtuar në mënyrë çnjerëzore **S.B.** dhe **H.D.**, dy civilë të cilët nuk kanë marrë pjesë në armiqësi, duke i mbajtur të mbyllur në kushte çnjerëzore (ndyrësi; mungesë ushqimi, mungesë uji dhe mungesë kujdesi mjekësor) në dhe përreth Novobërdës në mes të datave 19 dhe 22 prill 1999;

*krime lufte kundër popullsisë civile* në kundërshtim me nenet 22 dhe 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KP të RSFJ-së), aktualisht të dënueshëm me nenet 23 dhe 120 (2) të Kodit Penal të Kosovës (KPK), në kundërshtim me nenin e përbashkët 3 dhe me nenet 1 dhe 17 të Protokollit Shtesë II, pastaj me të gjitha rregullat e ligjit ndërkombëtar

në fuqi në kohën e konfliktit të armatosur në Kosovë si dhe gjatë gjithë kohës e cila ka të bëjë me akuzën e tanishme ndaj të pandehurve në cilësinë e tyre si oficerë ushtarakë apo paramilitarë serbë, duke përfshirë personat **D.T.**, **S.T.1.**, **S.T.2.** dhe **N.P.**, kanë shkelur integritetin trupor dhe shëndetësor të **S.B.** dhe të **H.D.**, dy civilë të cilët nuk kanë marrë pjesë në armiqësi, duke i rrahur në vazhdimësi në dhe përreth Novobërdës në mes të datës 21 prill 1999;

**S.S.**, me nofkën \_\_\_\_\_, e lindur më XX.XX.19XX, në fshatin \_\_\_\_\_ ( \_\_\_\_\_ ), nga prindërit T. dhe D., shtetase e Kosovës, me shkollim të mesëm të kryer, e pamartuar, me profesion \_\_\_\_\_, me gjendje të dobët ekonomike, e padënuar më parë;

E liruar në shkallën e parë nga vepra penale *krime lufte kundër popullsisë civile* në kundërshtim me nenet 22 dhe 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KP të RSFJ-së), aktualisht të dënueshëm me nenet 23 dhe 120 (2) të Kodit Penal të Kosovës (KPK), në kundërshtim me nenin e përbashkët 3 dhe me nenet 1 dhe 17 të Protokollit Shtesë II, pastaj me të gjitha rregullat e ligjit ndërkombëtar në fuqi në kohën e konfliktit të armatosur në Kosovë si dhe gjatë gjithë kohës deri në fazën e tanishme, e pandehura në fjalë në cilësinë e polices serbe ose të pjesëtares të formacionit paramilitar, në bashkëkryerje me oficerë tjerë ushtarakë apo paramilitarë serbë ka shkelur integritetin trupor dhe shëndetësor të **S.B.** dhe të **H.D.**, dy civilë të cilët nuk kanë marrë pjesë në armiqësi, duke i rrahur dhe posaçërisht duke e goditur **H.D.** në kokë me hu druri në dhe përreth Novobërdës më ose rreth datës 21 prill 1999;

Me aktgjykimin P Nr. 445/2010 të datës 22.07.2011 së Gjykatës së Qarkut të Prishtinës

**Duke vendosur mbi Ankesën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, të parashtruar më datën 08.11.2011, ndaj aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës nr. P 445 / 10 të datës 22.07.2011,**

*Pas shqyrtimit të përgjigjes së prokurorit të apelit të Kosovës nr. PPA 164 / 12 të datës 04.05.2011, të parashtruar më 07.05.2012;*

*Pas mbajtjes së seancës publike më 25.07.2013 në praninë e të akuzuare, të avokatëve mbrojtës, të prokurorit të shtetit Lulzim Sylejmani dhe të palëve të dëmtuara;*

*Pas këshillimit dhe votimit të mbajtur më 25.07.2013,*

Sipas neneve 420 dhe atyre në vazhdim të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) *sjell këtë:*

---

## AKTVENDIM MBI ANKESËN NDAJ AKTGJYKIMIT

---

**I. Ankesa e prokurorisë speciale e parashtruar më 08.11.2011 ndaj aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës nr. P 445 / 10 e datës 22 korrik 2011, pranohet.**

**II. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut të Prishtinës nr. P 445 / 10 i datës 22.07.2011 anulohet. Lënda i kthehet Gjykatës Themelore të Prishtinës për rivendosje dhe rigjykim.**

### ARSYETIM

#### **I. Procedura e gjertanishme**

1. Më 2 dhjetor 2010, prokurori special i Republikës së Kosovës ka ngritur aktakuzën PPS nr. 240 / 09 kundër të pandehurve **S.M.1.**, **S.M.2.** dhe **S.S.** dhe i ka akuzuar të njëjtit për veprat e përmendura penale të kryera kundër **S.B.** dhe **H.D.** Aktakuza është konfirmuar me aktvendimin KA. 411 / 10 të datës 31 mars 2011.

2. Shqyrtimi gjyqësor ka filluar më 7 qershor 2011 para kolegjit të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës të përbërë nga dy gjyqtarë të EULEX-it dhe një gjyqtar vendor. Edhe pesë seanca të tjera gjyqësore janë mbajtur më datat 16 qershor, 13 korrik, 14 korrik, 19 korrik dhe 20 korrik 2011.

3. Gjykata ka dëgjuar dëshmitë e këtyre dëshmitarëve: dëshmitë e palëve të lënduara **H.D.** dhe **S.B.**; **B.R.**, **F.M.**, **V.T.** dhe **I.P.** si dhe ka marrë në pyetje të pandehurit **S.M.1.**, **S.M.2.** dhe **S.S.** Përveç kësaj, palët janë pajtuar që të lexohen me zë nga procesverbali i shqyrtimit gjyqësor të gjitha dëshmitë e dhëna gjatë fazës hetimore nga dëshmitarët në vazhdim: **S.K.**, **B.C.**, **R.R.**, **N.A.**, **S.L.** dhe **R.B.**

4. Më 22 korrik 2011, kolegji i Gjykatës së Qarkut të Prishtinës ka shpallur aktgjykimin dhe ka gjetur se të pandehurit në fjalë janë fajtorë.

5. Më 8 nëntor 2011 është ushtruar ankesë nga prokurori special, ndërsa përgjigje ndaj kësaj ankese kanë paraqitur avokatët mbrojtës Miodrag Brklač, Dejan Vasić dhe Miro Delević, të gjithë më 29 nëntor 2011. Mendimi i prokurorit të shtetit është parashtruar më 7 maj 2012.

6. Më 1 janar 2013, lënda është kaluar nga Gjykata Supreme si gjykatë më herët kompetente në gjykatën e shkallës së dytë – Gjykatën e Apelit në përputhje me nenin 39, par. (1) të Ligjit mbi gjykatat, Ligjit nr. 03 / L - 199.

## **II. Parashtrësit e e palëve**

### **1. Ankesa e prokurorit special**

7. Prokurori special ka paraqitur ankesë me arsyetim se ka pasur shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale sipas nenit 403, par. (1), pika 8, lidhur me par. 2, pikën 1 të KPPK-së dhe vërtetim i gabueshëm i gjendjes faktike sipas nenit 405, par. 2 të KPPK-së. I njëjti propozon që Gjykata e Apelit ta anulojë aktgjykimin e kundërshtuar dhe ta kthejë lëndën në gjykatën e shkallës së parë për rivendosje dhe rigjykim.

8. Prokurori special pretendon se aktgjykimi i kundërshtuar është i bazuar në prova të papranueshme për shkak se gjatë procedurës penale, me rastin e marrjes së dëshmime të dëshmitarëve, nuk janë respektuar dispozitat ligjore. Në pjesën më të madhe të tij, aktgjykimi në fjalë mbështetet në dëshminë e marrë nga pala e dëmtuar **S.B.** më 21 shtator 2000 por forma e kësaj dëshmie është në kundërshtim me të gjitha dispozitat ligjore saqë nuk mund të konsiderohet fare dëshmi. Fakti që trupi gjykues i shkallës së parë nuk ka arritur të vërejë të gjitha lëshimet dhe ka konsideruar këtë dokument si deklaratë të vlefshme dhe madje edhe e ka mbështetur aktgjykimin e vet lirues kryesisht në atë dëshmi, përfaqëson shkelje esenciale të dispozitave të ligjit penal.

9. Prokurori special po ashtu pohon se dëshmitë e dhëna në polici në vitet 2007 dhe 2008 nuk janë marrë në përputhje me dispozitat ligjore për shkak të faktit se përkthyesit e përdorur nuk kanë dhënë betimin. Kjo gjë do të thotë se provat në fjalë janë marrë në mënyrë të gabueshme gjë e cila ka pasur ndikim në trupin gjykues i cili mori aktgjykimin e padrejtë në fjalë.

### **2. Përgjigjet e avokatëve mbrojtës**

10. Avokati mbrojtës Miodrag Brkljač i **S.M.1.** i propozon Gjykatës së Apelit refuzimin e ankesës dhe pohon se aktgjykimi në fjalë është i saktë dhe i ligjshëm. Dëshmitë në fjalë janë konsideruar të rregullta në kohën kur është ngritur aktakuza dhe e njëjta është trajtuar si provë kundër të pandehurve deri në përfundimin e shqyrtimit gjyqësor. Prokurori, si palë në procedurë, është dashur t'i propozonte gjykatës qysh në fazat më të hershme të procedurës (më së voni në seancën për konfirmimin e aktakuzës) që provën në fjalë ta shpallte të papranueshme dhe si të tillë ta hiqte nga shkresat e lëndës dhe jo vetëm të paraqiste propozimin në ankesën kundër aktgjykimit.

11. Avokati mbrojtës Dejan Vasić i **S.M.2.** i propozon Gjykatës së Apelit të refuzoj ankesën dhe paraqet se deklaratat e përmendura janë pjesë e vet aktakuzës. Nuk është kërkuar papranueshmëria e kësaj prove në seancën mbi konfirmimin e aktakuzës apo gjatë vet shqyrtimit gjyqësor. Gjykata e shkallës së parë bëri një analizë shumë të kujdesshme të të gjitha provave të prezantuara në shqyrtimin gjyqësor dhe nxori vendim të vlefshëm dhe të vetëm të mundshëm.

12. Avokati mbrojtës Miro Delević i **S.S.** i propozon Gjykatës së Apelit të refuzoj ankesën dhe paraqet se pala e dëmtuar **S.B.** vet erdhi në polici për të dhënë deklaratë, pa ftesë, pa presion apo shtypje pra askush nuk ka ndikuar në deklaratën e tij në aspektin se ajo ishte dhënë kundër vullnetit të tij dhe madje nën supozimin se ishin disa mangësi formale të policisë lidhur me marrjen e deklaratave që nuk ka ndikuar në faktet e paraqitura që përshkruajnë ngjarjen. Interpretimi i prokurorit për deklaratat e palës së dëmtuar është i pamundur për tu kuptuar dhe bazohet në supozime të cilat nuk mund të provohen.

### **3. Mendimi i prokurorit të shtetit të apelit**

13. Prokurori i shteti plotësisht mbështet ankesën e prokurorit special dhe i propozon Gjykatës së Apelit të prish aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë dhe të kthejë çështjen në Gjykatën Themelore në Prishtinë në rigjykim duke aprovuar ankesën e prokurorit special. Prokurori i shtetit paraqet se aktgjyrimi i ankimuar përmban shkelje të shumta esenciale të dispozitave të procedurës penale. Konkluzioni i gjykatës së shkallës së parë është tërësisht në kundërtënie me provat e administruara ndërsa arsyet e sjella në aktgjykimin janë të pamjaftueshme dhe nuk e arsyetojnë nxjerrjen e një konkluzioni të tillë. Në deklaratën e tij të dhënë gjatë procedurës penale, **S.B.** ka qenë kategorik në identifikimin e të akuzuarve si kryerës të veprave penale për të cilat ata akuzohen. Ajo dëshmi e palës së dëmtuar korrespondon me dëshminë e dëshmitarëve të përfshirë në procedurë e edhe në deklaratat e palës së dëmtuar **H.D.** Gjykata e shkallës së parë u mbështet në deklaratat e **S.B.** të sjella gjatë të gjitha fazave të procedurës penale. Gjykata mbështeti aktgjykimin e saj në prova të papranueshme.

## **III. Gjetjet e Gjykatës së Apelit**

### **1. Kompetenca e Gjykatës së Apelit**

14. Gjykata e Apelit është gjykatë kompetente për të vendosur për ankesa sipas nenit 17 dhe nenit 18 të Ligjit mbi gjykatat (Ligji nr. 03/L-199).

15. Kolegji i Gjykatës së Apelit është formuar në përputhshmëri me nenin 19 paragrafi (1) të Ligjit mbi gjykatat dhe nenin 3 të Ligjit mbi kompetencat, përzgjedhja e lëndëve dhe caktimi i lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovës (Ligji nr. 03/L-053).

## **2. Ligji procedural i aplikueshëm - *mutatis mutandis* Kodi i procedurës penale të Kosovës në fuqi deri më 31.12.2012**

16. Ligji procedural penal i aplikueshëm në lëndën penale përkatëse është Kodi i procedurës penale të Kosovës (i vjetri) që ishte në fuqi deri më 31.12.2012. Interpretimi i duhur i dispozitave kalimtare të Kodit të procedurës penale (të riut) në fuqi nga data 01.01.2013, përcakton se në procedurën penal të iniciuar para hyrjes në fuqi të kodit të ri, e për të cilën tanimë ka filluar shqyrtimi gjyqësor por nuk ka përfunduar ende me vendim të formës së prerë, do të zbatohen dispozitat e KPPK-së *mutatis mutandis* derisa vendimi të marrë formën e prerë. Në këtë aspekt i është referuar Mendimit ligjor nr. 56/2013 të Gjykatës Supreme të Kosovës, të miratuar në seancën e përgjithshme të saj më datë 23.01.2013.

## **3. Gjetjet mbi meritat**

17. Sikurse është paraqitur nga prokuroria speciale, Gjykata e Qarkut bazoi pjesën më të madhe të aktgjykimit të saj në deklaratën e dhënë nga pala e dëmtuar **S.B.** më 21.09.2000. Sipas të dhënave, deklarata është dhënë në stacionin policor të UNMIK-ut në Gjilan. Megjithatë të dhënat nuk përmbajnë ndonjë informacion lidhur me personat e tjerë të pranishëm, përveç përkthyesit, dhe në cilësinë e kujt ishin të pranishëm.

Prandaj është e paqartë kush e mori ose kush e shkroi deklaratën. Kjo është shkelje e nenit 80 të Ligjit të procedurës penale (nr. 26/86, LPP), ligj i aplikueshëm në kohën e deklaratës, dhe nenit 87 të KPPK-së. Nuk ka të dhëna se **S.B.** është njoftuar për të drejtën e tij të lexoj shënimet dhe nga ajo që tregojnë shkresat e lëndës, deklarata kurrë nuk është përkthyer në shqip për t'i dhënë rast **S.B.** ta lexoj atë. Më tej deklarata nuk është nënshkruar nga **S.B.** Kjo e gjitha është në shkelje të nenit 82 të LPP-së dhe nenit 89 të KPPK-së. Për më tepër, nga ajo çfarë të dhënat tregojnë, **S.B.** nuk është paralajmëruar apo njoftuar për të drejtat dhe obligimet e tij sipas nenit 231 të LPP-së apo nenit 164 të KPPK-së. Në këtë aspekt, Gjykata e Apelit pajtohet me prokurorin special se një deklaratë e tillë nuk mund të konsiderohet deklaratë korrekte e dëshmitarit.

18. Shkeljet e përmendura megjithatë nuk e bëjnë deklaratën të papranueshme sikurse është parashtruar nga prokurori special se provat e marra me shkelje të dispozitave të procedurës penale janë të papranueshme vetëm kur kodi apo dispozitat e tjera të ligjit shprehimisht parashikojnë kështu sipas nenit 153 të KPPK-së. Papranueshmëria e deklaratës së dëshmitarit është e rregulluar me nenin 161 të KPPK-së dhe një dispozitë e ngjashme ishte edhe në LPP, neni 228. Megjithatë nëse Gjykata e Apelit konsideron se lëshimi për të zbatuar dispozitat e kodit ka mundur të ketë ndikim në nxjerrjen e një aktgjykimi të ligjshëm dhe të duhur, kjo prapë përbën shkelje substanciale të dispozitave të procedurës penale sipas nenit 403 paragrafi 2 pika 1 të KPPK-së.

19. Është rregull e përgjithshme që dihet se deklaratat e dëshmitarit të dhëna më afër kohës së ndodhive zakonisht janë më të sigurta dhe të besueshme se sa deklaratat e dhëna më vonë sepse me kalimin e kohës hollësitat mund të harrohen. Kjo megjithatë varet nga kushte të caktuara, e njëra nga ato është se dëshmitari është i lirë gjatë gjithë kohës që të shpreh hapur atë çfarë ai di. Në rrethana të paqarta dhe të pasigurta që zakonisht shfaqen në lidhje me luftërat dhe kohët turbulente sikurse ishte në Kosovë në vitin 2000, dëshmitari ka mundur të mos jetë në gjendje që lirshëm të shpreh njohuritë e tij kur është thirrur të jap deklaratë. Rrethanat e tilla mund të shkaktojnë përjashtim nga rregulli i përgjithshëm i saktësisë në deklaratat më afër ngjarjeve. Bazuar në këtë, një deklaratë e hershme prandaj mund të jetë më e pasaktë sesa një deklaratë e mëvonshme.

20. Kur ka analizuar deklaratat e **S.B.**, trupi gjykues i Gjykatës së Qarkut i kushtoi vëmendje të veçantë përmendjes të tij të të pandehurve, apo më mirë mungesës së tyre. Fakti se **S.B.** nuk i përmendi të pandehurit si pjesëmarrës në rrahje në vitin 2000 dhe 2007 konsiderohet një mospërputhje substanciale. Në të gjitha deklaratat e tij të mëvonshme **S.B.** vazhdimisht ka deklaruar se të pandehurit kanë marrë pjesë në rrahje, por mungon përmendja e tyre në dy deklaratat e tij të para që mban peshën më të rëndë për trupin gjykues. Deklaratat nga 2000 dhe 2007 janë shumë të shkurtra dhe u mungojnë hollësitat. Lidhur me deklaratën nga 2000 ne në fakt nuk e dimë nëse i ishin bërë pyetje dëshmitarit për shkak të të metave të paraqitura më parë. Lidhur me deklaratën e vitit 2007 është e qartë se nuk i ishin bërë pyetje dëshmitarit pasi që ajo ishte deklaratë e shkruar me dorë dhe e dhënë nga vet viktima. Mungesa e emrave të të pandehurve si kryerës në dy deklaratat e para, u konsiderua nga trupi gjykues një mospërputhje lidhur me atë se çfarë deklaroi **S.B.** në shqyrtimin gjyqësor sidoqoftë kjo nuk ishte shqyrtuar si duhet në shqyrtimin gjyqësor. **S.B.** vetëm shkurtimisht është pyetur në lidhje me atë në të cilën pikë ai thotë se e ka treguar ngjarjen që nga viti 2000 dhe kjo mund të ketë qenë lënë pas dore nga personi që e ka shkruar. Trupi gjykues nuk e beson këtë. Gjykata e Apelit pajtohet se nuk është e mundur që procesmbajtësi i gjykatës apo përkthyesi të shpiknin fakte megjithatë nuk është e pamundur që për shembull emrat të lihen anash nëse deklarata nuk është marrë fjalë për fjalë dhe në këtë rast nuk është e mundur të dihet pasi që nuk i dimë rrethanat kur është marrë deklarata dhe për shkak se **S.B.** nuk ka mundur ta kontrolloj raportin e shkruar të deklaratës së tij, ne nuk mund të kundërshtojmë atë kur thotë se i ka përmendur emrat e të pandehurve.

21. Në konkluzion, duke i marrë parasysh të gjitha këto dhe pas shqyrtimit të deklaratave të **S.B.** dhe dëshmitarëve të tjerë në lëndë, Gjykata e Apelit konsideron se shkeljet e dispozitave të lartë përmendura kanë mundur të ndikojnë në nxjerrjen e një aktgjykim të ligjshëm dhe të duhur, e në veçanti për shkak se trupi gjykues i Gjykatës së Qarkut u mbështet në këto deklaratat të mëhershme deri në një masë të tillë të konsiderueshme.

22. Pasi ka gjetur se ka pasur shkelje substanciale të dispozitave të procedurës penale, Gjykata e Apelit duhet të prish aktgjykimin dhe të kthej lëndën në rigjykim sipas nenit 424 paragrafi 1 të KPPK-së. Prandaj u vendos si në dispozitiv.

*Përgatitur në gjuhën angleze, gjuhë e autorizuar.*

Kryetari i kolegjit

---

Tore Thomassen  
gjyqtar i EULEX-it

Anëtarja e kolegjit

---

Annemarie Meister  
gjyqtare e EULEX-it

Anëtari i kolegjit

---

Vahid Halili  
gjyqtar

Procesmbajtësja

---

Anna Malmström  
zyrtare ligjore e EULEX-it